



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 22/2010

Prishtinë më 01. 06. 2010, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Zef Morina, Fatmir Rexhepi, Mufëra Şinik, Adem Grabovci, Qamile Morina, Sala Berisha – Shala dhe Kaqusha Jashari.

Munguan: Murselj Haljilji.

Pjesëmarrës të tjerë: Ekrem Hoxha kryetar, Lulzim Kurtaj, Besnik Berisha - Bordi i ART-së, Besnik Ramadanaj – KDI dhe Ibrahim Krasniqi - konsulent.

Stafi mbështetës: Advije Morina, Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Nuriye Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të datës 25. 05. 2010;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit - ART për vitin 2009;
4. Të ndryshme.

***Kryetarja** konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të 25. 05. 2010

Procesverbali i mbledhjes së 25. 05. 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit - ART për vitin 2009

Kryetarja – Për të paraqitur Raportin Vjetor të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit - ART për vitin 2009 ia dha fjalën kryetarit të Bordit z. Ekrem Hoxha.

Ekrem Hoxha - kryetar i Bordit të ART-së – E kemi përgatitur Raportin konform dispozitave të Ligjit në fuqi dhe të aktiviteteve kryesore që kanë vlejtur për t'u paraqitur në raport të këtij formati. Të gjithë jeni dëshmitarë se Raporti i vitit 2009, krahasuar me vitin 2010 ka qenë mjaft i mangët, për arsye se nuk ka pasur shumë aktivitete të Rregullatorit brenda ART-ës për shkak të mungesës së Bordit për një periudhë gati nëntë muajore. Jemi munduar t'i paraqesim ato aktivitete, të cilat kanë ndodhur në mungesë të Bordit, edhe pas emërimit të Bordit të ri nga Kuvendi i Kosovës. Hyrja paraqet një aktualitet në aspektin ligjor, ku gjendet ART-ja sot kundrejt kornizës ligjore, me të cilin punojnë rregullatorët e tjerë në rajon dhe mbështetjet e BE-së. Rregullatori në Kosovë ende punon me rregullore, e cila është një kornizë që nuk i përcjell trendët aktualë në zhvillimin e sektorit e të komunikimeve elektronike. Si ART jemi shumë të angazhuar për bashkëpunim me ministrin e Transportit dhe të Postelekomunikacionit që ta japim kontributin tonë në hartimin e projektligjit të ri, i cili kaloi sipas agjendës legjislative nga fundi i këtij viti në Kuvendin e Kosovës. Përparësitë dhe nevojat për një ligj të ri janë paraqitur në Raport. Do të jemi të hapur për t'iu përgjigjur shqetësimeve tuaja në pjesën e pyetjeve. Edhe pse duhet ta ripotencojmë se ligji në fuqi është një kombinim i mirë i paketës AK-98 dhe i paketës 2003, sidomos në pjesën e konkurrencës ose të promovimit të konkurrencës dhe të realizimit të tregut. Me një fjalë mandati ynë mbetet me ligjin në fuqi. Me liberalizimin e mëtutjeshëm të Ligjit të telekomunikacionit, konsolidimi dhe riorganizimi i ART-së ishin në funksion me kërkesat e ligjit në fuqi. Fillimi i analizës dhe i monitorimit të tregut ishin obligim dhe ushtrim i ART-së që nuk janë kryer më herët, as deri më tani. I kemi filluar aktivitetet dhe një obligim tjetër lidhur me marrëdhëniet me institucionet e tjera, qofshin vendore ose ndërkombëtare, me interes për Rregullatorin. Gjatë vitit 2009, një prej zhvillimeve kryesore, lidhur me veprimtarinë, është se ne si ART kemi filluar të merremi me këtë çështje, pra e kemi bërë rishqyrtimin e të gjitha licencave të lëshuara gjatë mandatit të Bordit për periudhën dhjetor 2008 dhe shtator 2009. I kemi bërë legalizimin dhe formatizimin e atyre licencave, të cilat i kanë plotësuar kriteret dhe dispozitat lidhur me rregulloren në fuqi. Janë katër licenca, të cilat kanë qenë

subjekt pa mandat ligjor të Bordit, të cilat janë në faqet 11-të dhe 15-të. Licencat për shfrytëzim të frekuencave, që janë individuale dhe jepen nga Departamenti për Menaxhim të Frekuencave, të cilat janë me zhvillim më të përshpejtuar edhe janë procedura mjaftë të strukturuar. Në vitin 2009, në dhjetor, ART-ja ka bërë një analizë të resurseve, në dispozicion të resurseve njerëzore dhe një ristrukturim profesional pa i lëvizur resurset aktuale. Ka bërë një lëvizje në bazë të performancave dhe e ka përpiluar një organogram, i cili është në funksion të jetësimit të ligjit në fuqi, pa e marrë parasysh ligjin i cili pritët të aplikohet. Këtë organogram e kemi paraqitur në raport për arsye që të mos e ngarkojmë me të dhëna. Në bazë të vlerësimit tonë 45 - 50 anëtarë duhet të jetë stafi sipas ligjit në fuqi, aktualisht veprojmë me 30 punëtorë. Ky është një ndryshim shumë i madh dhe i limiton kapacitetet e rregullatorit. Në faqen 14 një prej aktiviteteve, që vlen të përmendet, është intensifikimi i aktiviteteve me Rregullatorin nga shtetet e rajonit dhe nga Bashkimi Evropian. Si rezultat i atij angazhimi dhe si rezultat i angazhimit në këtë vit i kemi nënshkruar 3 kontrata me Rregullatorin e Malit të zi, të Maqedonisë dhe atë të Shqipërisë. Këtë muaj presim të nënshkruhet kontrata edhe me Republikën e Turqisë. Ky është një kontribut shumë i madh për këto shtete të rajonit. Lidhur me interferencat kufitare, është edhe detyrim reciprok për t'i rregulluar këto interferenca kufitare dhe ndërkufitare. Kemi dhënë një bagazh të mjaftueshëm në atë drejtim, përfshirë edhe operatorët jolegalë. Sa i përket ndërprerjes së veprimit të operatoreve ilegalë nuk janë përfshirë në këtë Raport, sepse këto masa janë ndërmarrë këtë vit, kurse Raporti që sot është në diskutim, është i vitit 2009.

Kryetarja – Ua dha fjalën deputetëve për të shtruar pyetje rreth Raportit në diskutim.

Fatmir Rexhepi – ART-ja ka një punë me specifika të veçanta në sektorin që e mbulon dhe është një agjenci e themeluar nga Kuvendi. Për shkak të vonesave gjatë vitit 2009 organizimin dhe kompletimin e saj, këtë veprimtari e ka dëmtuar dukshëm dhe ka krijuar pasoja në sektorin e telekomunikacionit. Këtë që e dëgjuam sot, mendoj se është e rëndësishme së veçantë, jo vetëm për ekonominë, por edhe për të gjithë qytetarët. Për ta vënë në binarë dhe në kornizën e aktiviteteve, që kjo fushë të organizohet, sepse ka impakt shumë të madh me jetën tonë të përditshme, për qytetarët, për familjen dhe për biznesin. Ky Raport, që u paraqit këtu nga kryetari, mendoj se është shumë i mirë, sepse është i kompletuar, ashtu siç duhet të jetë një raport para Komisionit, i cili duhet të dalë para Kuvendit. Me një përkrahje të fortë për të gjitha këto aktivitete, të cilat i ka zhvilluar për një kohë shumë të shkurtër, që nga një tetori kur e ka marrë detyrën ky Bord, për krejt rezultatet dhe objektivat që janë pasqyruar në këtë Raport. Duhet ta përkrahim këtë Agjenci. Ajo që më intereson ta di janë operatorët e palicencuar. Këtu qëndron fakti se ka pasur shumë dhe ka ende të tillë në Kosovë. Do të doja ta dija se a keni mundur t'i identifikoni të gjitha zonat edhe sa janë këta operatorë? Një shpjegim më konkret, lidhur me këtë, sepse këtu ka një ndërhyrje në zona të caktuara, ka një pengesë në krejt hapësirën e Kosovës. Çështja e dytë janë të hyrat vetjake, buxheti i ndarë në mjete, si po funksionon dhe a është në interes të mbahet ky autoritet apo të mbyllet?

Ethem Çeku – Gjatë një periudhe të caktuar janë dhënë shumë licenca. Është bërë edhe rishqyrtimi lidhur me shuarjen e tyre. Pra dua ta di a ka pasur shkelje të procedurës në të kaluarën? Çështja e dytë është ajo e operatorëve ilegalë. A keni bërë marrëveshje ju si

ART me vendet e rajonit? E treta, është pse nuk e keni sjellë Raportin e auditimit, sepse në atë Raport është folur shumë keq për juve. Nëse mendoni se ai Raport nuk ka pasur shkelje, është dashur të shkojë në Kuvend dhe të diskutohet. Çështje tjetër është ajo e financimit, sa janë krijuar të hyrat? Si veprojnë dhe si funksionojnë dy operatorët e fundit: D3-shi dhe Z-mobile?

Adem Grabovci - I përgëzoj për punën e suksesshme që është bërë, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë që e kanë trashëguar nga e kaluara, sepse janë përballur me probleme jashtëzakonisht të mëdha. Shihet qartë se kanë filluar të fusin situatën nën kontroll. Unë do të doja të dija, përveç numrit të operatorëve ilegalë, të cilët operojnë në Kosovë, sa i shkaktojnë dëme buxhetit të Kosovës? Të na jepet, lidhur me këtë, një pasqyrë më e kompletuar për ta parë se deri ku keni arritur në këtë drejtim. Po ashtu lidhur me çështjen e resurseve njerëzore, gjegjësisht me kapacitetet tuaja, a keni mundësi nga buxheti juaj të krijoni të ardhura apo ju duhet buxhet shtesë?

Qamile Morina - Edhe pse konsideroj se është një raport me terma mjaft profesionalë, është e rëndësishme se i keni paraqitur mangësitë, të cilat i keni pasur në mungesë të Bordit, i keni kompensuar, d.m.th. detyrimet tuaja, në të vërtetë të operatorëve, pas përzgjedhjes së Bordit. Pyetjet e mia kanë të bëjnë me: Ju keni bërë momerandume mirëkuptimi për shkëmbimin e përvojave me këto qendra, mua më intereson ta di si është çështja e privatizimit në këto vende? Ju i keni shkëmbyer përvojat me Maqedoninë, me Malin e Zi edhe me Shqipëri, me të cilët keni bërë memorandume. Si është gjendja e privatizimit të PTK-së? Nga viti 2005 ART-ja e përfaqëson Kosovën si entitet të veçantë nga Serbia, meqë e kemi prefiksin e njëjtë, do të doja të dija çka do të thotë kjo? Ajo që shihet prej Raportit është se neve punët e telekomunikacionit po na shkojnë shumë mirë. Te ne deputetët po shfaqin dilema për angazhimin ose për diskutimin që po bëhet. Po flitet për privatizimin e telekomunikacionit. Nga raportet tuaja shihet se të gjitha trendët janë jashtëzakonisht pozitivë. Pyetja tjetër ka të bëjë me licencimin, me fituesin e operatorit virtual, Dardafonin, me të cilin dihet se është nënshkruar kontrata. Gjithashtu kontrata është nënshkruar edhe me Dardafon-net. Pra kush e fitoi tenderin, kur këto janë dy shoqata me numër plotësisht të ndryshëm? Është e paqartë si ishte e mundur ta merrte tenderin një shoqatë, nga ajo paraprake, që e kishte nënshkruar tenderin?

Kaqusha Jashari - Kam vetëm një pyetje, edhe pse jam pro miratimit të Raportit. Keni nevojë për njerëz të profileve të ndryshme. Kemi kërkuar përkrahje për shkak të limitit buxhetor. A është ky problem momental edhe çfarë limiti keni ju, edhe për sa agjenci të pavarura? Kemi shumë vërejtje për borde, për të ardhurat e tyre. Sipas referimit tuaj, si duhet të jetë përkrahja jonë?

Zef Morina - Të gjitha agjencitë dhe të gjitha bordet kanë pasur përvojë shumë të hidhur me ART-në, për shkak të raporteve të cilat i ka pasur vetë ART-ja, duke e pasur parasysh Ligjin e Telekomunikacionit, si autoritet i pavarur, sepse këto autoritete e kanë pavarësinë e tyre në aspektin e veprimit profesional. Ky Raport është i përsosur në atë mënyrë, më tepër nga afati që e keni paraqitur, sepse është një afat shumë i shkurtër. Unë i kam vërejtur disa gjëra, të cilave u ka kaluar koha, sepse ka më shumë se dy vjet që nuk është raportuar as në Komision, as në Kuvend. Në kohën kur kemi kërkuar që ART-ja të

raportonte, kishte një lloj injorimi ose jogatishmërie. Pyes, pavarësisht se ky Bord është zgjedhur nga Ministria, si i keni raportet tani me Ministrinë? Mendoj se nëse raportet vazhdojnë si më parë, frikohem se nuk do të ketë sukses, ashtu siç nuk ka pasur edhe më herët. Thatë se i keni shqyrtuar licencat, të cilat janë marrë nga viti 2008 – 2009, në kohën kur Bordi nuk ka funksionuar fare, por ka vendosur vetëm një individ. Sipas kësaj shihet se ato licenca janë rikonfirmuar edhe një herë. A janë rikonfirmuar për arsye se janë nënshkruar nga një proces rregullativ i mëparshëm? Për këtë arsye keni qenë të detyruar ose keni bërë ndonjë shqyrtim të mirëfilltë dhe nuk i keni shkelur procedurat, ashtu siç e parasheh ligji. Mendoj se do të ishte më mirë të na sqaroni hollësisht se deri ku keni arritur me interferimin. Çështje tjetër, është se operatorët virtualë, këtu thotë pas aprovimit të kornizës nga ART-ja, në maj të vitit 2008 janë licencuar edhe dy operatorë. D3 mobile operon bazuar në marrëveshjen komerciale me Ipko-n ndërsa Dardafoni ose Z-mobile, me operatorin publik. Në ligj e kemi shumë qartë të përcaktuar se në Kosovë mund të licencohet vetëm edhe një operator. Arsyeja dihet, pse ka qenë kështu, në atë kohë në vitin 2003. Operatorët ilegalë, të cilët operojnë në Kosovë, nuk i keni cekur. Trajtimi buxhetor, është e vërtetë se fusha telekomunikuese është shumë atraktive. Ajo kërkon kuadër profesional. Çdo anëtar, sidomos anëtarët e Bordit dhe ekspertët paguhesh shumë mirë. Ju e keni pagën e një deputeti. Do të thosha të mos grumbullohen shumë njerëz aty, vetëm sa për të marrë paga. Ata duhet ta kryejnë detyrën. Thjeshtë nga puna e tyre vetë ART-ja dhe telekomunikacioni, por edhe Kosova të kenë dobi. Është folur që ju në kohën e fundit jeni në kontakt më palën serbe, lidhur me një operator tjetër të telefonisë mobile. Është mirë të bëhen përgatitjet, mirëpo për shkak të operimeve të tjera ilegale ligji nuk e lejon këtë. Çështja kryesore e kodit të telefonisë mobile, sigurisht është çështje më tepër e Ministrisë. Arsyeja, meqë nuk jemi anëtarë të OKB-së, nuk kemi të drejtë ta kemi kodin, nuk qëndron. Duhet të dilet në opinion e t'u thuhet qytetarëve se kjo nuk është e vërtetë. Kodi telefonik merret prej ITU-së. Shumica e anëtarëve të saj votojnë dhe duhet ta ketë mbështetjen mbi 50% të anëtarëve të ITU-së. Të gjithë e dimë se ekziston kodi i ndarë për Kosovën, i cili vetëm duhet të formalizohet dhe duhet t'i ndahet. Një pyetje tjetër, deri më tash, kur janë bërë thirrjet telefonike jashtë vendit, ka qenë 99, tani 00, si qëndron raporti ndërmjet daljeve edhe hyrjeve. Në përgjithësi raporti është shumë i mirë dhe kemi shpresë se do të jeni shumë më të kujdesshëm edhe në punën që bëni në harmoni më ligjin.

Sala Berisha Shala – Në fillim po them se e mbështes Raportin. Në bazë të pyetjeve, të cilat i parashtuan kolegët e mi, mendoj se nuk mbeti asgjë pa u përmendur. Po ashtu mendoj se keni pasur sfida të ndryshme, duke pasur parasysh si e ka lënë Bordi i kaluar gjendjen. Sipas asaj që unë vlerësova, më duket se është paraqitur një realitet, pavarësisht asaj se çka vlerësojmë si deputetë. Sipas të gjithave duket se ka hapësirë për t'u bërë edhe më mirë. Lidhur me kodin e telefonisë, se ju duhet t'i krijoni hapësirë Ministrisë që të llojë më tutje për kod, a ka mbetur diçka që nuk është bërë në Agjencinë tuaj në mënyrë që t'i hapë rrugë Qeverisë të llojë në këtë drejtim. Në qoftë se ka mbetur, të dihet se a po punohet në atë drejtim, ku janë pengesat, a duhet një bashkëpunim më i ngushtë reciprok ndërmjet të Agjencisë dhe Qeverisë?

Kreytarja - Pikë së pari, Raporti me shumë vonesa, më në fund është kompletuar. Duke marrë parasysh rëndësinë e ART-së, më në fund u kompletua ky Bord. Është hera e parë

që Bordi i ART-së raporton brenda këtij Komisioni Parlamentar. Në bazë të Raportit, të cilin ju e keni sjellë në Kuvend, shihet mungesa e infrastrukturës ligjore dhe e ridraftimit të ligjit në përphje me kohën, nëpër të cilën kalon çështja e telekomunikacionit, e infrastrukturës së telekomunikimit. Me gjasë në këtë drejtim kemi ngelur mbrapa. Çështja e liberalizimit të tregut dhe Ligji i telekomunikacionit lejojnë vetëm një operator. Edhe brezi i frekuencave të telefonisë mobile në Kosovë është bërë rrëmujë. Pa marrë parasysh këtë duhet të potencohen më shumë këto gjëra. Kur bëhet fjalë për marrëveshje me vendet fqinje, fjala është për telefoninë mobile, që të funksionojë në territorin e Kosovës, do të ishte mjaft mirë të potencohet të mos kemi humbje në buxhetin fiskal të Kosovës. Çështja e kodit telefonik, ju i zbatoni politikat e Ministrisë në bazë të ligjit dhe çështja e inspektimit të ART-së për të hyrat, të cilat ju i potencuat, janë çështje shumë primare. Duke e marrë parasysh se ky është autoritet i pavarur në bazë të Ligjit të telekomunikacionit dhe duhet të jetë autoritet, në të cilin punojnë ekspertë, pse nuk mund t'i mbledhni të dhënat tuaja? Çështja e kodit telefonik, mendoj se duhet të merrni pjesë nëpër shumë konferenca ndërkombëtare, ndoshta jo të numrit të madh të njohjeve, por për arsye që ta bëni sa më të njohur. PTK-ja, si një kompani publike, e cila është mjaft profitabile dhe çdo vit i ndan dividendat e veta për Qeverinë e Kosovës. Si agjenci e pavarur që jeni, cilat janë kompetencat tuaja? Cilat janë kompetencat tuaja për privatizimin e posttelekomunikacionit të Kosovës? Rekomandimi im i fundit është, siç e potencoj edhe z. Çeku, çështja e auditimit, që kërkoj të shtrohet në mbledhjen e radhës.

Ekrem Hoxha - U përgjigj në pyetjet e parashtruara: Për çështjen e operatorëve ilegalë janë bërë shumë pyetje. Dua të jemi të qartë se ART-ja pas gjithë asaj pune përgatitore të 23 - 24 prillit, pas matjeve, mbi 30 matje, i kemi dy stacione mobile të teknologjisë së fundit, të cilat janë më të avancuara në Kosovë. I kemi bërë 30 matje, i kemi përcaktuar koordinatat, vendndodhjet dhe detajet teknike për 26 stacione. Bazë për to janë qendrat ku përpunohen të dhënat. Dhjetë ekipe të ART-së me Policinë e Kosovës kanë çmontuar kontraktorë dhe i kanë sekuestruar pajisjet kryesore telekomunikuese. Në ato vende kanë mbetur vetëm shtyllat, por ajo nuk paraqet relevancë infrastrukturore. Ato 26 stacione bazë nuk janë rikthyer në funksion, sepse po flitet se ka rikthim të sinjalit, por ende nuk i kanë ato 26 stacione. Pajisjet janë sekuestruar dhe janë në një depo me siguri të lartë. Konform dispozitave të rajonit, brenda 60 ditëve i presim pretendimet e pronarëve. Presim se kush ka pretendime ligjore për ato pajisje. Pas përfundimit të afatit 60-ditor, pasi ta bëjmë vlerësimin pajisjeve, do të iniciohet procedura e shitjes. Gjendja aktuale është kështu: pas 23 - 24 prill, e kemi bërë publike se i kemi riaktivizuar matjet në terren me ato dy stacione mobile, ku kemi konstatuar mbetjen e stacioneve të tjera brenda territorit të Kosovës. Gjithmonë po flas duke e përjashtuar Veriun. Në ato 12 stacione të mbetura, tri janë joaktive, por ne i kemi lokalizuar ato. Ato do të jenë subjekt i fazës së dytë të aksioneve. Në fazën e dytë, për dallim me fazën e parë, që u realizua sipas mendimit dhe funksionimit tonë, duke ju falënderuar edhe krahut të fuqishëm politik dhe përkrahjes pa rezervë të Policisë së Kosovës, ju kemi dhënë afat 30 ditë operatorëve dhe pronarëve, që ti çmontojnë ose të mos i lejojnë këto 12 stacione, që të mos jenë objekt i përsëritur. I kemi sekuestrua 26, kurse kanë mbetur 24. Ia kemi dërguar njoftimin edhe Rregullatorit të Serbisë. Me këtë shkresë ua kemi bërë me dije t'i informojnë operatorët, MTS-in dhe Telenorin, ta tërheqin infrastrukturën e tyre, në qoftë se duan të jenë subjekt i sekuestrimit, si në fazën e parë. Deri më sot nuk kemi asnjë reagim në lidhje me këtë.

Në fazën e dytë kemi koordinim më të mirë me KFOR-in, me EULX-in, me ICO-në, me Ambasadën Amerikane edhe me institucionet vendore. Veriu ka mbetur për arsye politike. Ne si ART nuk kemi pasur informacione të mjaftueshme që të provokohemi. ART-ja ka kompetenca për territorin e Kosovës. Kemi kordinata për Veriun, por nuk është kompetencë jona ta urdhërojmë Policin ose institucionet e rendit për jetësimin e vendimin tonë. ART-ja do të vazhdojë edhe në Veri, mirëpo varet nga mbështetja institucione relevante. Te hyrat vetjake, edhe kjo ishte njëra ndër pyetjet e parashtruara. Për ta kuptuar qartë se ART-ja gjeneron të hyra të rregullta vjetore në një plan pa aktivitetet licencuese në brezat ose në resurset e fundit. Rreth 3 - 4 milionë të hyrash është nga ato licenca, të cilat vijnë nga resurset e frekuencave dhe nga kanalet. Trafikimi i kanaleve dhe enumeracioni, në këtë vit do fillojmë me fatura, sepse nuk është faturuar asnjëherë në këtë vit. Këto janë të hyrat e rregullta, ndërsa buxheti i rregullt pa projekte kapitale është 800 mijë euro. Në proporcion me të hyrat buxheti është shumë më i ulët. Ky buxhet rezulton me paga 470 euro. Është një pagë shumë e ulët, krahasuar me ato profile që i marrin tek operatorët. Mund të them se nuk ka trajtim të njëtrajtshëm në krahasim me shërbyesit civilë. Ne themi që pagat të vendosen me miratim të Bordit, për të cilin mendoj se është shumë profesional për të administruar aso vendimesh. Sa janë operatorët ilegalë në shfrytëzim, mund të them se kapacitetet janë shumë të limituara dhe të parëndësishme për tregun, por u është krijuar hapësirë operatorëve të licencuar që me vendime menaxheriale produktet e tyre të nxjerrin në treg. Marrëveshje ndërkufitare, këto memorandume të mirëkuptimit në aspektin ligjor nuk mund të quhen marrëveshje ndërkufitare, për arsye se Ministria i ka precizuar me ligj. Për atë arsye i quajmë marrëveshje mirëkuptimi, mirëpo kanë obligime reciproke brenda kapaciteteve të rregullatorëve. E kemi arritur një mirëkuptim shumë të mirë me Maqedoninë, me Shqipërinë dhe me Malin e Zi që të harmonizohen emitime reciproke. Gjatë qershorit me Shqipërinë dhe me Maqedoninë do të nënshkruhet një marrëveshje e dytë, si aneks, ku do të precizohen konform ITU-së. Operatorët do të obligohen me një vendim tonin brenda në Kosovë, që VALA dhe IPKO-ja ta ulin fuqinë transmetuese andej kufirit. Me Rregullatorin e Maqedonisë urojmë që kjo sivjet të rregullohet. Sfidë mbetet terreni i Malit të Zi, sepse është i pafavorshëm për territorin e Kosovës. Përkundër zvogëlimit, penetrimi do të jetë më i thellë në Kosovë. Mendoj se me këto marrëveshje do të rregullohen këto çështje. Raporti i auditimit, kërkojmë ndjesë që është i vonuar. Ne, Komisionit për Buxhet, ia kemi dërguar sot pas dite dhe do të dorëzohet në sekretari. Funksionimi i EMVIENO-s, që po përflitet shumë në media, duhet ta kemi të qartë çka nënkupton. EMVIENO-ja nënkupton operatorin virtual, i cili e shfrytëzon infrastrukturën e operatorëve të rrjetit. Mbetet në gjykimin e operatorëve të rrjetit të PTK-së, të VALA-s dhe të IPKO-s si e shfrytëzojnë atë infrastrukturë me produktivitet të shtuar për të gjeneruar të hyra shtesë nga mosshfrytëzimi i infrastrukturës në dispozicion. Pra për ART-në nuk ka angazhim të resurseve të frekuencave për D3-in ose Z-mobile, por ata e shfrytëzojnë infrastrukturën e operatorëve të rrjetit dhe regjenerojnë produkte me identitet të ndryshëm, për arsye se janë operatorë të licencuar me kapacitete teknike që i potencojnë. Bartja në Dardafon dhe Dardafon net është komplet ligjore dhe janë dhënë arsyetimet për ato të cilat i administron EULEX-i. Ne nuk shohim asnjë paqartësi nga aspekti rregullator. Ne këtë çështje, përveç se shohim vlerë të shtuar për tregun e shohim edhe përfitimin nga qytetarët lidhur me produkte të ndryshme. Dhe dua të them se operatorët e rrjetit janë dy dhe kanë arrit marrëveshje komerciale.

Pas debatit Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

- I. Shtyhet shqyrtimi i Raportit vjetor të ART-së për vitin 2009 për mbledhjen e radhës,*
- II. Për çështjet e hapura në mbledhjen e radhës të ftohen përsëri përfaqësuesit e ART- së për sqarim të mëtutjeshëm.*

4. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 13: 00

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani